



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE
KUALIFIKIMEVE**


Nr. 33 Prot.

Tiranë, më 15.01 2020

MIRATOHET

DREJTORI

EJVIS GISHTI



RREGULLORE E BRENDSHME

**PËR PËRZGJEDHJEN DHE SHPËRBLIMIN E SPECIALISTËVE TË JASHTËM
ME KONTRATË PËR REALIZIMIN E VEPRIMTARIVE ZHVILLIMORE NË
FUSHËN E ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL**

TIRANË

Neni 1

Objekti

1. Kjo Rregullore ka për objekt përcaktimin e procedurës së përzgjedhjes së specialistëve të jashtëm me kontratë dhe modalitetet e shpërblyerjes së tyre, për realizimin e veprimtarive zhvillimore në fushën e Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP), në përmbushje të detyrave të “Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve”, (më poshtë AKAFPK) në përputhje me objektivat dhe misionin ligjor të saj.
2. Kjo Rregullore përcakton kuadrin e brendshëm juridik të nevojshëm për mbarrëvajtjen e veprimtarisë së institucionit, duke siguruar barazinë dhe transparencën e procesit të përzgjedhjes së specialistëve të jashtëm me kontratë, si dhe duke garantuar pjesëmarrjen aktive të tyre në veprimtarinë e kësaj Agjencie.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo rregullore mbështetet në Kushtetutën e Shqipërisë, Ligjin “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve”, Ligjin për Arsimin e Lartë, i ndryshuar, Ligjin për Arsimin Parauniversitar, Ligjin për Statusin e Nëpunësit Civil, Kodin e Procedurave Administrative, VKM-në nr. 673, datë 16.10.2019 “Për organizimin dhe funksionimin Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve”, shkresën e Sekretarit të Përgjithshëm të MAS-it, nr.2100/1 prot., datë 03.04.2014 “Kthim përgjigje”, të shkresës nr. 63, datë 25.03.2014 të AKAFPK “Mbi prokurimin elektronik të shërbimeve të specializuara në fushën e veprimtarisë së AKAFPK”, shkresën e Sekretarit të Përgjithshëm të MAS-it, nr. Prot., 4290/2, datë 05.12.2013 “Mbi raportin final me rekomandime të Auditit të realizuar nga MAS nga data 09.09.2013 deri më datë 20.09.2013” (pika nr. 3 e rekomandimeve) dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen me veprimtarinë e këtij institucioni.

Neni 3

Subjektet

1. Subjektet të kësaj Rregulloreje janë **kandidatët për specialistë të jashtëm me kontratë**, të cilët kërkojnë të ofrojnë shërbimet e tyre për të ndihmuar AKAFPK-në në realizimin e **detyrave kryesore** të saj si më poshtë:
 - a. Harton dhe rishikon Listën Kombëtare të Profesioneve, në bashkëpunim me Institutin e Statistikave, përfaqësuesit e sektorëve ekonomikë etj.;
 - b. Harton dhe rishikon Katalogun Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale për nivelet 2-5 të KSHK-së;
 - c. Harton dhe rishikon standardet e profesioneve;
 - d. Harton dhe rishikon standardet e kualifikimeve profesionale të niveleve 2-5 të KSHK-së, në terma të rezultateve të të nxënies, si dhe të standardeve të vlerësimit për kualifikimet profesionale;

- e. Këshillohet me palë të interesuara për zhvillimin, zbatimin dhe rishikimin e procedurave për përfshirjen e kualifikimeve në KSHK;
 - f. Propozon ndryshimet në kritere dhe procedura për sigurimin e cilësisë së kualifikimeve profesionale, që përfshihen në KSHK;
 - g. Ndjek procedurat për vlefshmërinë e cilësisë së kualifikimeve, pjesë e KSHK-së, në bashkëpunim me komitetet sektoriale;
 - h. Harton dhe rishikon programet (kurrikulat) kombëtare për kualifikimet profesionale të niveleve 2-5 të KSHK-së;
 - i. Harton dhe rishikon programet e kurseve të unifikuara të formimit profesional publik;
 - j. Monitoron zbatimin e standardeve dhe të programeve (kurrikulave) kombëtare nga institucionet publike ofruese të AFP-së;
 - k. Përcakton kriteret e vlerësimit dhe të certifikimit të nxënësve e kursantëve në sistemin e AFP-së;
 - l. Harton materialet mësimore mbështetëse për ofruesit e AFP-së;
 - m. Harton programet orientuese të provimeve të niveleve dhe provimit të maturës shtetërore profesionale për çdo kualifikim profesional të niveleve 2-5 të KSHK-së;
 - n. Harton dhe rishikon standardet, kriteret dhe procedurat e akreditimit të ofruesve të AFP-së;
 - o. Akrediton ofruesit e AFP-së për kualifikimet profesionale të niveleve 2-5 të KSHK-së si dhe qendrat e vlerësimit për zbatimin e procedurave të njohjes të të nxënësve të mëparshëm joformal dhe informal;
 - p. Harton programet kombëtare, administron dhe monitoron procedurat për kualifikimin dhe atestimin e vazhduar të mësuesve dhe instruktorëve të kulturës profesionale të AFP-së;
 - q. Mbështet metodologjikisht njësitë e zhvillimit të ofruesve të AFP-së;
 - r. Mbështet ofruesit e AFP-së për zhvillimin dhe sigurimin e cilësisë në përputhje me kriteret e akreditimit;
 - s. Harton dhe rishikon standardet dhe kriteret e akreditimit të qendrave për zhvillimin e procedurave të njohjes të të nxënësve të mëparshëm joformal dhe informal;
 - t. Harton dhe zbaton projektet kombëtare e ndërkombëtare për jetësimin e prioriteteve në fushën e AFP-së;
 - u. Mbështet administrativisht organet tripalëshe të përfshira në zhvillimin e AFP-së, në përputhje me mandatin dhe funksionet e institucionit.
2. Komisioni i ngritur me urdhër të Drejtorit të AKAFPK-së do të realizojë përzgjedhjen e specialistëve të jashtëm me kontratë, sipas procedurave të përcaktuara në këtë Rregullore.

Neni 4

Regjistrimi i kandidatëve, specialistë të jashtëm me kontratë

1. Nevojat e AKAFPK-së për specialistë të jashtëm me kontratë përcaktohen me anë të Urdhërit të Drejtorit të AKAFPK-së, bazuar në kërkesat e sektorëve përkatës.
2. Drejtori i AKAFPK-së urdhëron publikimin në faqen zyrtare të Internetit të AKAFPK-së njoftimet për aplikim të kandidatëve për specialistë të jashtëm me kontratë, të cilat përmbajnë:
 - a) specififikimet e detyrës për të cilën do të angazhohen specialistët e jashtëm me kontratë;
 - b) kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta për përzgjedhjen e tyre;
 - c) listën e dokumenteve që duhet të paraqesin;
 - d) afatin e fundit dhe mënyrën e aplikimit
3. Specialistët e jashtëm me kontratë ndahen në tri kategori (referuar Pikës 9 të VKM nr. 673, datë 16.10.2019) dhe duhet të plotësojnë këto kërkesa të përgjithshme:
 - a. Specialistë të kategorisë së ulët, që kanë një diplomë të arsimit të mesëm profesional ose të përgjithshëm (shoqëruar me kualifikime profesionale) dhe përvojë pune mbi 3 vjet, këto në fushën për të cilën lidhet kontrata;
 - b. Specialistë të kategorisë së mesme, që kanë një diplomë të arsimit të lartë ("Bachelor"/niveli 6 i KSHK-së) dhe përvojë pune mbi 5 vjet, këto në fushën për të cilën lidhet kontrata;
 - c. Specialistë të kategorisë së lartë, që kanë një diplomë të arsimit të lartë ("Master i shkencave", "Master Profesional", doktoratë/niveli 7-8 i KSHK-së) dhe përvojë pune mbi 10 vjet, këto në fushën për të cilën lidhet kontrata.
4. Specialistët e jashtëm me kontratë duhet të plotësojnë edhe kërkesa të veçanta që hartohen në funksion të veprimtarive zhvillimore për të cilat do të kontraktohen (referuar Lidhjes 2 të VKM nr. 673, datë 16.10.2019), si më poshtë.
 - 4.1. Për hartimin dhe rishikimin e dokumenteve që përmbajnë veprimtaritë në Pikat I dhe II:
 - a) të kenë mbaruar arsimin e mesëm ose të lartë në fushën përkatëse profesionale;
 - b) të njohin metodologjinë e hartimit të dokumenteve sipas këtyre pikave;
 - c) të kenë marrë pjesë në veprimtari të ndryshme trajnuese për zhvillim e tyre profesional.
 - d) të këtë përvojë në fushën profesionale përkatëse dhe/ose mësimdhënie.
 - 4.2. Për hartimin dhe rishikimin e dokumenteve që përmbajnë veprimtaritë në Pikat III dhe IV:
 - a) të kenë mbaruar arsimin e mesëm ose të lartë në fushën përkatëse profesionale;
 - b) të njohin metodologjinë e hartimit të dokumenteve sipas këtyre pikave;
 - c) të kenë marrë pjesë në veprimtari të ndryshme trajnuese për zhvillim e tyre profesional.
 - d) të këtë përvojë në fushën profesionale përkatëse dhe/ose mësimdhënie.

4.3. Për hartimin dhe rishikimin e dokumenteve që përmbajnë veprimtaritë në Pikat VI dhe VII:

- a) Të kenë mbaruar arsimin e mesëm ose të lartë në fushën përkatëse profesionale;
- b) të kenë përvojë si mësues dhe/ose instruktorë në arsimin e mesëm profesional, në arsimin e lartë, në formimin profesional;
- c) të kenë përvojë pune në fushën përkatëse;
- d) të jenë në kushte shëndetësore të mira për të kryer detyrat përkatëse;
- e) të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup;
- f) të kenë aftësi për të përdorur literaturë në gjuhë të huaj;
- g) të përdorin kompjuterin.

4.4. Për hartimin dhe rishikimin e dokumenteve që përmbajnë veprimtaritë në Pikat IX dhe XI:

- a) të kenë diplomë të arsimit të lartë ("Master i shkencave", "Master Profesional", doktoratë/niveli 7-8 i KSHK-së);
- b) të kenë përvojë si trajnerë të mësuesve dhe instruktorëve të AFP;
- c) të kenë përvojë në përgatitjen e programeve të trajnimit të mësimdhënësve të AFP;
- d) të kenë përvojë pune si mësimdhënës në AFP.

4.5. Për hartimin dhe rishikimin e dokumenteve që përmbajnë veprimtaritë në Pikën X:

- a) të kenë diplomë të arsimit të lartë ("Master i shkencave", "Master Profesional", doktoratë/niveli 7-8 i KSHK-së);
- b) të kenë përvojë si mësimdhënës në fushën/lëndën përkatëse;
- c) të kenë aftësi për të përgatitur materiale të shkruara;
- d) të kenë aftësi për të përdorur literaturën në gjuhë të huaj;
- e) të kenë aftësi për të përdorur programet kompjuterike.

4.6. Për hartimin dhe rishikimin e dokumenteve që përmbajnë veprimtaritë në Pikat XII dhe XIII:

- a) të kenë përvojë si mësimdhënës në fushën/lëndën përkatëse dhe fushën përkatëse profesionale;
- b) të kenë kualifikime në fushën e vlerësimit të nxënësve në AFP;
- c) kenë aftësi për të përdorur programet kompjuterike.

4.7. Për akreditimin e ofruesve të AFP-së dhe të qendrave të njohjes së të nxënësve të mëparshëm, në Pikat VIII dhe XX:

- a) të kenë diplomë të arsimit të lartë ("Master i shkencave", "Master Profesional", doktoratë/niveli 7-8 i KSHK-së);
- b) të kenë përvojë sipas fushave të akreditimit;
- c) të kenë kualifikime në fushën e vlerësimit të jashtëm të institucioneve arsimore.

4.8. Për konsulenca të jashtme që bënë validimin e dokumentacionit në Pikën XV:

- a) të kenë diplomë të arsimit mesëm dhe/ose të lartë në fushën përkatëse;
- b) të kenë përvojë në mësimdhënie dhe/ose në profesion në fushën përkatëse.

4.9. Për moderimin e jashtëm të procesit të hartimit të dokumentacionit sipas Pikës XVI:

- a) të kenë diplomë të arsimit të lartë ("Master i shkencave", "Master Profesional", doktoratë/niveli 7-8 i KSHK-së);
- b) të kenë përvojë në moderim të proceseve të hartimit të dokumentacioneve sipas pikave I-XIII;

- c) të ketë aftësi shumë të mira komunikuese dhe të punës në grup;
- d) të kenë aftësi për të përdorur literaturën në gjuhë të huaj;
- e) të kenë aftësi për të përdorur programet kompjuterike.

4.10. Për moderimin e jashtëm të procesit të hartimit të dokumentacionit sipas Pikave XVII-XVIII:

- a) të kenë diplomë të arsimit mesëm dhe/ose të lartë në fushën përkatëse;
- b) të kenë përvojë në mësimdhënie dhe/ose në profesion në fushën përkatëse.

4.11. Për trajnimet e mësuesve, instruktorëve dhe përfaqësuesve/instruktorëve sipas pikës XIX:

- a) të kenë diplomë të arsimit të lartë ("Master i shkencave", "Master Profesional", doktoratë/niveli 7-8 i KSHK-së);
- b) të kenë përvojë si trajner i mësimdhënësve;
- c) të ketë aftësi shumë të mira komunikuese dhe të punës në grup;
- d) të kenë aftësi për të përdorur literaturën në gjuhë të huaj;
- e) të kenë aftësi për të përdorur programet kompjuterike.

5. Kandidatët për specialistë të jashtëm me kontratë duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kërkesë për Aplikim referuar njoftimit përkatës për aplikim;
- b) Curriculum Vitae;
- c) Fotokopje e Diplomës së arsimit të lartë ose të mesëm;
- d) Dokument që vërteton kohëzgjatjen e përvojës në punë, në fushën përkatëse;
- e) Fotokopje të dokumenteve që tregojnë kryerjen e kualifikimeve, trajnimeve dhe specializimeve të ndryshme (në se disponohen).

Neni 5

Përzgjedhja e specialistëve të jashtëm me kontratë

1. Procedura e përzgjedhjes së specialistëve të jashtëm me kontratë, fillon me publikimin e njoftimit për shpalljen e nevojës për këta specialistë, në faqen zyrtare të internetit të AKAFPK-së.
2. Për kryerjen e procedurave të përzgjedhjes të kandidatëve, Drejtori i AKAFPK-së, me urdhër, ngre komisionin përkatës. Komisioni vlerëson kandidatët konkurues mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur dhe të kërkesave të shpallura.
3. Në përfundim të procesit të vlerësimit, Komisioni merr Vendim për shpalljen e fituesve dhe e publikon në njoftimin përkatës në faqen e Internetit të AKAFPK-së
4. Kandidatët për specialistë të jashtëm me kontratë, kanë të drejtë të ankimojnë (me shkrim) vendimin e Komisionit brenda një afati prej 3 ditësh pune qysh nga publikimi i njoftimit për fituesit. Drejtori i AKAFPK-së shqyrton ankimimin dhe merr vendimin përfundimtar brenda 3 ditësh pune qysh nga paraqitja e ankimit.

Neni 6

Përbërja e Komisionit të përzgjedhjes së specialistëve të jashtëm me kontratë

1. Komisioni i ngritur për përzgjedhjen e specialistëve të jashtëm me kontratë përbëhet si më poshtë:

- a) Kryetari i Komisionit (Drejtori i AKAFPK-së);
- b) Përgjegjës i Sektorit të Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale;
- c) Përgjegjës i Sektorit të Skeletkurrikulave dhe Standardeve të Trajnimit të Mësuesve të Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP);
- d) Përgjegjës i Sektorit të Vlerësimit, Certifikimit të Nxënësve dhe Akreditimit të Ofruesve të AFP-së;
- e) Përgjegjës i Sektorit të Administratës, Financës dhe Teknologjisë së Informacionit.

2. Anëtarët e Komisionit, përpara se të bëjnë përzgjedhjen e specialistëve të jashtëm me kontratë, duhet të nënshkruajnë një deklaratë që nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me personat pjesëmarrës si kandidatë për specialistë të jashtëm me kontratë.

Neni 7

Vlerësimi i kandidatëve për specialistë të jashtëm me kontratë

1. Komisioni shqyrton dokumentacionin e kandidatëve për specialistë të jashtëm me kontratë dhe me Vendim përcakton fituesit në përputhje me kërkesat përkatëse.
2. Komisioni mban proces verbal lidhur me vlerësimin e kandidatëve dhe shpall listën e fituesve.
3. Komisioni i merr vendimet me shumicën e votave të anëtarëve të tij prezent në procesin e vlerësimit.

Neni 8

Shpallja e fituesve dhe lidhja e Kontratave

1. Pas shpalljes në faqen zyrtare të AKAFPK-së të vendimit përfundimtar për fituesit si specialistë të jashtëm me kontratë, ata duhet të paraqiten jo më vonë se 5 ditë nga shpallja dhe të lidhin kontratën, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Fituesit si specialistë të jashtëm me kontratë, të angazhuar në veprimtaritë e AKAFPK-së, do të lidhin kontratë shërbimi individuale me AKAFPK-në.

Neni 9

Të drejtat dhe detyrat e specialistëve të jashtëm me kontratë

1. Specialistët e jashtëm me kontratë gëzojnë të gjitha të drejtat që u njeh ligji dhe kontratat e lidhura me AKAFPK-në.

2. Specialistët e jashtëm me kontratë kanë për detyrë të zbatojnë me përpikëri të gjitha detyrimet që burojnë nga kontrata e lidhur dhe legjislacioni në fuqi.

Neni 10

Trajtimi financiar i specialistëve të jashtëm me kontratë

1. Trajtimi financiar i specialistëve të jashtëm me kontratë bëhet sipas Pikës 9 të VKM nr. 673, datë 16.10.2019, duke konsideruar masën e pagesës për kategoritë e specialistëve, sipas Lidhjes nr. 1, si dhe vëllimin e punës për veprimtaritë zhvillimore përkatëse, sipas Lidhjes nr. 2 të këtij Vendimi.
2. Në ato raste kur, në Lidhjen nr. 2, orët e punës për kryerjen e veprimtarive zhvillimore tregohen me intervale, orët e punës për të cilat do të lidhen kontratat përkatëse llogariten sipas kriterëve të përcaktuara në Lidhjen n. 2 të detajuar, bashkëlidhur kësaj Rregulloreje.

Neni 11

Publikimi i njoftimeve

Të gjitha njoftimet lidhur me procedurat e aplikimit për specialistë të jashtëm me kontratë gjenden në adresën e faqes zyrtare të Internetit të AKAFPK-së www.akafp.gov.al ,

Neni 12

Zbatimi i Rregullores

Personeli i AKAFPK-së dhe specialistët e jashtëm me kontratë janë të detyruar të respektojnë kërkesat e kësaj Rregulloreje.

Neni 13

Miratimi dhe hyrja në fuqi

Drejtori i AKAFPK-së miraton këtë Rregullore dhe pas miratimit, hyn menjëherë në fuqi.

Neni 14

Ndryshimi apo shfuqizimi

Ndryshimet, amendimet apo shtesat e nevojshme në këtë Rregullore bëhen me propozim të Drejtorive të AKAFPK-së, dhe me miratimin e Drejtorit të AKAFPK-së. Ndryshimet, amendimet apo shtesat e nevojshme në këtë Rregullore hyjnë në fuqi pas miratimit nga Drejtori i AKAFPK-së.

Neni 15

Parashikime të fundit

Pas miratimit të kësaj Rregulloreje nga ana e Drejtorit të AKAFPK-së, çdo akt administrativ që rregullon çështjet e përzgjedhjes së specialistëve të jashtëm me kontratë dhe që bie ndesh me këtë rregullore shfuqizohet.